



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

PROCESVERBAL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE VEGLA PUNE DHE AKSESOR ”, Procedurë e hapur e thjeshtuar - mallra, me afat sipas kërkesave të AK”

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.275.623 (Nje milion e dyqind e shtatedhete e pese mijë e gjashtëqind e njezet e tre) Lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkoder sha, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Specifikime teknike	Njësia	Sasia
1	Detektor (Monitorues) per 4 gazra-CO, O2, H2S, LEL (SMART SENSOR ST8900	LEL-gaz të djegshëm, O2-oksigen, CO-monoksid karboni, H2S-sulfide hidrogjen	Copë	2
2	Tabela per punime ne rruge e sheshe urbane	trekendore, drejtkendeshe, me shenime e ngjyra perkatese per punime ne rruge	Copë	4
3	Matrapik per thyerje 1700 w	Tension I punes 220 v, Frekuenca 50Hz Fuqia (1700)W Nr I goditjeve ne minute 1000-1400.	Copë	2
4	Shirit tregues per punime ne rruge e sheshe urbane	me ngjyre kuq+bardh, gjeresi 10 cm, plastik rezistent, 100 m/copa topi	Copë	85
5	Fiksuese ne forme hallkash per lidhje kavo - 10, 12, 16 mm	Materiali i kornizës : çelik I galvanizuar (5 cope per çdo tip)	Copë	15
6	Kapëse mbërthyes e rregjistrueshme, (TIP Patkua) M8, M10, M14, M16, M20	Materiali i kornizës : çelik I galvanizuar (5 cope per çdo tip)	Copë	25
7	Brushë metalike	për heqje ndryshku	Copë	5
8	Punto matrapiku sheshte		Copë	2
9	Punto matrapiku me maje		Copë	2
10	Tel celiku	Tel celiku Ø8, zhbllokim ujra te zeza	ml	30

11	Tel celiku	Tel celiku Ø6, zhbllokim ujra te zeza	ml	30
12	Tel celiku	Tel celiku Ø10	ml	12
13	Leve ndertimi me 2 maja ø =18 mm	Materiali: Çelik i farketuar. Gjatesia=700 mm, ø =18 mm	Copë	4
14	Leve karpentieri ø =16 mm	Materiali: Çelik veglash. Gjatesia=750 mm, ø =16 mm	Copë	4
15	Leve karpentieri ø =16 mm	Materiali: Çelik veglash. Gjatesia=450mcm, ø =16 mm	Copë	4
16	Leve dore te kthyera	Kompleti ka 4 cope, Me doreze çelik i farketuar	Komplet	5
17	Morsete banaku -5"	Me rrotullim. -5''	Copë	1
18	Morsete dore	Materiali çelik. Kapja 50 mm. Gjatesia 155mm.	Copë	2
19	Kose	kos me bisht per prerjen e barit	cope	5
20	Kon tregues per punime ne rruge e sheshe urbane	me ngjyre Kuq e bardh, gjeresia e bazes 30x30 cm, lartesia 60 cm, plastik rezistente	Copë	10
21	Komplet kriketi me koka kriketi Cr-Vd	1/4"+ 3/8" + 1/2"	komplet	1
22	Lopata	Lopata me bazë ovale, 23x27 cm është e përshtshme për transferimin e materialeve inerte. dhe punimin e tokes Materiali prej çeliku i tempëruar siguron fortësi dhe qëndrueshmëri.	Copë	30
23	Kazma	Kazma per pune ne terren	Copë	3
24	Gur fleksibel me bateri		cope	8
25	Shirit ngjites -25ml per materiale gome.plastike etj .Temperatura max grade(Rula)	Shirit ngjites -25ml per materiale gome.plastike etj., Temperatura max grade (Rula)	Copë	4
26	Litar d=12 mm	Materiali Poliaster, i zi, Rezistent ndaj ujit vajit naftes.	ml	93
27	Litar -d=14 mm	Litar -d=14 mm Materiali Poliaster, i zi, Rezistent ndaj ujit vajit naftes	ml	91
28	Furça boje vaji	Per lyerje me boje vaji	cope	25
29	Elektrik dore	me njesi karikimi 36volt	cope	5
30	Set me 5 dalta te sheshta	• Maje e temperuar/• Materiali: Chrome Vanadium special Maje e temperuar/• Materiali: Chrome Vanadium special	Komplet	1
31	Hinke plastike me kend diameter 180 mm	diametri I hinkës 180 mm	Copë	5
32	Pincë prerëse kablli		Copë	2
33	Pincë zhveshje teli	Gjatesia 175 mm	Copë	2
34	Pincë për kapikorda	Gjatesia 250 mm	Copë	2
35	Pince elektrike e izoluar Cr-Vd	Gjatesia 200 mm, 1000V. Profesionale	Copë	2
36	Pince hidraulike/mekanike	Materiali: Çelik veglash me doreze plastike. Gjatesia 250 mm. Rregjistrimi i kapjes mekanik me disa pozicione (jo me filet)	Copë	2

37	Pince hidraulike ½”, 45	Materiali: Çelik veglash. Gjatesia 250 mm. Rregjistrimi i kapjes me filet	Copë	4
38	Pince hidraulike 1”, 45	Materiali: Çelik veglash. Gjatesia 250 mm. Rregjistrimi i kapjes me filet	Copë	4
39	Pincë me nofull të kthyer, me rregjistër, Cr- Vd	Materiali: Krom-Vanadium/ Gjatesia 225 mm	Copë	2
40	Pincë me dhembzim te drejte , me rregjistër, Cr- Vd	Materiali: Krom-Vanadium. Gjatesia 250 mm	Copë	2
41	Pince prerje bulonash Cr- Vd	Materiali: Krom-Vanadium/ Profesional. Gjatesia 350mm	Copë	2
42	Pince per fermo hapje nga jashte me maja te drejta	Materiali: Krom-Vanadium /Profesional. Gjatesia 180 mm	Copë	2
43	Pince per fermo hapje nga jashte me maja te kthyera	Materiali: Krom-Vanadium /Profesional. Gjatesia 180 mm	Copë	2
44	Pince per fermo hapje nga brenda me maja te drejta	Materiali: Krom-Vanadium. Profesional. Gjatesia 180 mm	Copë	2
45	Pince saldimi 500 A		Copë	4
46	Pince per fermo hapje nga brenda me maja te kthyera	Materiali: Krom-Vanadium. Profesional. Gjatesia 180 mm	Copë	2
47	Çelesa fiso-Poligon me kriket		komplet	2
48	Çelesa fiso-Poligon Cr-Vd .	Numri i çelesave (6-22). Materiali: Krom-Vanadium. Profesional	komplet	2
49	Çelesa fiso-Poligon Cr-Vd .	Numri i çelesave (23-46). Materiali: Krom-Vanadium. Profesional	komplet	2
50	Çelesa Poligon me hark Cr-Vd. Numri i çelesave (6-22).	Materiali: Krom-Vanadium (6-22). Profesional	komplet	1
51	Çelesa Poligon. Numri i çelesave (6-32).	Materiali: Çelik me Karbon (6-32)	Komplet	1
52	Çeles heksagonal, Cr-Vd	Materiali: Krom-Vanadium (2-16). Profesional.	Komplet	2
53	Elektro-gur me ajer	– Përmasat e Diskut: 125 mm (fileto M14)/ – Fuqia: 840 W/ – Numri i xhirove për minut RPM: 12.000/ – Konsumi /mesatar i ajrit: 11 l/s/ – Dimensioni min. i tubit të ajrit Ø10 mm – Pesha: 1,6 kg	Copë	1
54	Ç’filetues bulonash	Perdorimi: Per bulona M3-45	Komplet	2
55	Çelesa yll “T” Cr-Vd	Materiali: Krom-Vanadium T (10-30). Profesional	Komplet	2
56	Çelesa busull 6-32 te gjate	Materiali: Krom-Vanadium. Profesional	Komplet	2

57	Çeles filter vaji, nafte e tjere	Kompleti ka 4 cope: 1-Me zinxhire manual. 1-Me zinxhire me kriket. 1-Me fashete metalike. 1-Me nofulla me kriket	Komplet	2
58	Çeles tubular te drejte 6-22 mm	Materiali: Krom-Vanadium	Komplet	2
59	Çeles universal i shpejte (tip grepi). Kapja deri ne 50 mm	Materiali: Krom-Vanadium	Komplet	4
60	Çelës hidraulik	Profesional me permasa 200mm. Nofullat e çelesit jane te trajtuar termikisht dhe trupi çelik I lyster me pjekje siguron qendrueshmeri mekanike, I pershtatshem per rakorderite nga 0-28mm	Copë	3
61	Brava Dyersh		Copë	39
62	Tutjus	per puseta	Copë	25
63	Tutjus	dry	Copë	1
64	dryn, hekuri 63mm	per mbylljen e portave, cantat e veglave, etj. Per vrime jo me te vogel se 11mm, me tre çelësa	Copë	40
65	Prerëse bari	Prerëse bari Model MS-26U	cope	1
66	Kazma	Kazem guri, 1.8 kg, celik I farketuar Kazem e pershtatshme per punime te tokave te forta dhe tyerjen e materialeve te serte te ndertimit si: beton, gure, pllaka, etj. Ndertuar nga celik cilesor dhe prodhuar me ane te procesit te farketimit, per rezistence maksimale ndaj sforcimeve goditese. Funktionale per bishtat standart te drurit. Pesha prej 1.8 kg mundeson balancim te mire midis fuqise goditese dhe manovrimit te lehte gjate punes. Ideale per profesioniste te fushes se ndertimtarise.	Copë	10
67	Bishta lopate 120cm	Bisht druri me përmasa 120cm, është e përshtshme për lopata. I prodhuar nga nje material druri mjaft rezistent , dhe i punuar me makineri per ti dhene nje forme dhe rehati ne perdorim.	Copë	10
68	Gërshërë tubi	Tub PVC PE	Copë	8
69	Sharrë hekuri 440mm	Sharrë hekuri profesionale, 12", 30 cm, me konstrukt solid dhe me dorezë plastike për kapje të mirë dhe komforte. Forma katrore në fundin e konstruktit mundëson vendosjen e lamës në katër pozicione të ndryshme. Ideale për prerje vertikale dhe horizontale. Sharra është rezistente ndaj ndryshkjes.	Copë	2
70	Punto betoni ø4- ø12 mm	me slite	Seri	4
71	Punto betoni ø14- ø20 mm		Seri	4

72	Punto freze metali-Tubulare ø20 mm		Copë	1
73	Punto betoni 12mm	Përdoret për të shpuar në të gjitha llojet e betonit dhe materialet e ngjashme me të. E ndërtuar me çelik special, është shumë e qëndrueshme dhe siguron një shpim të shpejtë	Copë	5
74	Karroce dore + gome	me kapacitet mbajtës 80 Lt/ 160 kg, çelik i galvanizuar, 1360x600x580 mm	Copë	1
75	Rrul për lyerje	poliamid/çelik, 18 cm	Copë	3
76	Furça per lyerje	120X30mm Furça është e përbere nga fije natyrale me densitet të lartë. është ideale për lyerje te sipërfaqeve druri dhe metali.	Copë	10
77	Furçë gëlqereje me dalje anesore, plastike	përdoret me bojra me bazë uji . Furça është e përbere nga fije natyrale me densitet të lartë. është ideale për lyerje te sipërfaqeve te medha .	Copë	15
78	Kaçavide me kriket	Kompleti me 16 koka vidash	Copë	8
79	Kaçavid mekaniku me goditje komplet Cr-Vd	Materiali: Krom-Vanadium	Komplet	4
80	Çelës kriket me dinamometer	3/8", 70-100 Nm	Komplet	4
81	Tub ajri spiral me bashkues te shpejte universale, gjatesia=15 m	Presioni max: 8 bar/ Gjatesia: 15 metra/ Diametri: 12 mm	Copë	2
82	Pistoletë pastrimi ajri		Copë	4
83	Pistoletë fryrje gomash me manometer		Copë	3
84	Lidhes ngarkese bulon me sy, M8, M10, M12, M14, M16, M20, M24	Materiali i kornizës: çelik I galvanizuar (5 per çdo tip)	Copë	30
85	Lidhes ngarkese vrime e filetuar me sy, M8, M10, M12, M14, M16 M20, M24	Materiali i kornizës: çelik I galvanizuar (5 per çdo tip)	Copë	30
86	Testues baterish		Copë	5
87	Pajisje per hapje cilindrave te frenave (Ekstrator)		Copë	1
88	Ekstrator koka zbare e paraleli		Komplet	1
89	Gomina rrethore (mbi 400 cope)		Komplet	1
90	Pajisje Zhvidosje bulonash, vidash 18-20v		Komplet	1
91	Moto Prerëse Asfalti	Lloji i karburantit: Benzin/ Thellësia e punimit: 140 mm/ Diametri i diskut: 300-450 mm/ Fuqia: 8-10 kw	Copë	2

92	Çeles T me koke te rrotullueshme profesional ¼'', 3/8'', 1/2''	nga 1 per lloj	Copë	1
93	Aparat Saldimi inverter	300 A	Copë	1

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetë-deklarimit”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”. Me anë të këtij kriteri AK kërkon të jetë i siguar për gjendjen aktuale të OE, për përmbushjen me sukses të kësaj kontrate.

b. Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1;

c. Listën e Çmimeve sipas Shtojcës 2.

Argumentimi: Kriteret e mësipërm (b, c) janë bazuar në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 15, “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit”, pika 2.

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 30 “Sigurimi i ofertës”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;” dhe pika 2: “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund

të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë...”, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”.

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022,2023, me një vlere jo me te ulet se 40% e fondit limit te ketij prokurimi. **Kjo Kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.**

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancin vjetor, për vitin financiar 2022, 2023 shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3: “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të jet e madhe se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës...”bazuar ne nenin 43 te VKM-në Nr. 285 datë: 19. 05. 2021 ““Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore kërkohet bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30. 01. 2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Bilancet per dy vitet e fundit jane kerkuara bazuar ne nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/4, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" dhe sherben per te njohur gjendjen financiare te operatoreve ekonomik ofertues

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:

- a) per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlere, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara,
- b) per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose ne rastin e procedurave te thjeshtuara ne nenin 55, pika 4/b), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Me ane te ketij kriteri kerkohe qe operatoret ekonomik te deshmojne qe kanen pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten, prandaj eshte kerkuar qe sherbimet e meparshme te ngjashme te jene ne vleren jo me pak se 20 % te vleres se fondit limit, qe eshte brenda vleres kufi te percaktuar ne nenin e sipercituar.

Percaktimi i vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme argumentohet si me poshte:

Kontrata e ngjashme eshte e domosdoshme per te vertetuar ekspriencen e operatoreve ekonomik ofertues, me qellim qe te garantohet zbatimi i kontrates me sukses.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikata te vlefshme:

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente te sistemit te menaxhimit te cilesisë,

Qellimi i certifikimit te kompanise duhet te jete sipas fushes se objektit qe do te prokurohet. Certifikatat te jene leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte vendosur bazuar ne nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik". Ky kriter eshte gjykuar si i domosdoshem, pasi kjo certifikate garnaton autoritetin kontraktor qe operatoret ekonomik ofertues ofrojne cilesine ne furnizimin e mallrave objekt kontrate.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një Deklaratë që merr përsipër transportin dhe lëvrimin e mallrave drejt ambienteve magazinuese të Autoritetit Kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenin 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është vendosur për të shërbyer autoritetit kontraktor si garanci që operatori ekonomik fitues të garantojë sjelljen e mallit deri në magazinat e UK Shkoder.

Njesia e prokurimit